



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 05.01.2021,
duke filluar në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Egzon Azemi, Fadil Gashi, Vala Peshku, Sami Boroci dhe Genc Sherifi.

Munguan: Blerand Stavileci.

Të pranishëm ishin edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues.

Para së të fillonin me diskutime për pikat e rendit të ditës, **Osman Bllaca** tha se kemi një propozim nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm: **"Propozimvendimi për plotësim - ndryshimin e Vendimit, 01-464/01-263767/18, të dt. 01.11.2018, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës"**.

Njëherësh ai tha se ka mundësi të jenë edhe dy-tri pika shtesë për Kuvend, e ato janë: Propozimvendime të këmbimit të pronave, derisa të sqarohen, dhe për këto vendos Kryetari.

Genc Bashota tha se bëhet fjalë për Presidencën e Ambasadorit, jo për Ambasadën, dhe kjo ka kaluar në Kuvend më herët, por kanë kërkuar një bashkim të parcelave.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa;

Faqe 1 nga 7

2. Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike;
3. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin 2019;
4. Informatë nga Drejtoria e Parqeve mbi menaxhimin e hapësirave të gjelbra dhe parqeve në komunën e Prishtinës;
5. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit" në Prishtinë;
6. Propozimvendimi për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme, për vitin 2021;
7. Propozimvendimi për formimin e komisionit për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021;
8. Diskutim lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL-së, "Termokos", SHA, Prishtinë;
9. Propozimrregullorja e punës së Këshillit drejtues të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona" ;
10. Propozimrregullorja për caktimin e procedurave të dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim për më pak se një vit;
11. Propozimvendimi për subvencionimin e çerdheve me bazë në komunitet;
12. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, 01-464/01-263767/18, të dt. 01.11.2018, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
13. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbaleve të mbledhjes së pestë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së pestë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Medina Braha, drejtoreshë e DSHP, tha se këtë material e kemi dërguar më herët, por meqë u shty deri më tani, jemi duke punuar për ta përfunduar raportin komplet për vitin 2020, dhe në ndërkohë këtë raport do ta dërgojmë komplet.

Kryesuesi theksoi se është kohë e shkurtër deri në Kuvend me pritje raport tjetër, por ky material të prezantohet në mbledhjen e Kuvendit.

Agim Gashi fillimisht bëri vërejtje rreth termit "Ligjet e zbatueshme", i cili tha se duhet të hiqet ky formulim, pasi që tani në Kosovë nuk ka ligje të pazbatueshme, pra kjo do të duhej të përmirësohej.

Po ashtu, kur flitet për kompetencat e komisionit në situata emergjente, te detyrat e atyre departamenteve në kuadër të drejtorisë, ku përshkruhen detyrat dhe obligimet e tyre, thuhet: "Komisioni i propozon Kryetarit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme".

Këtu duhet të përmirësohet dhe të thuhet: "Komisioni bashkë me Kryetarin", se Kryetari e udhëheq komisionin, si reagues të parë dhe kompetent në nivel komunal, dhe i propozojnë Presidentit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme.

Emergjencat janë çështje tjetër, nivel më i ulët i shkallës së rrezikshmërisë. Aty është mirë të përmirësohet, se kjo votohet në Kuvend dhe të mos përcillet një gabim, që është në kundërshtim me ligjet që rregullojnë atë fushë, menaxhimin e emergjencave, dhe Ligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera.

Egzon Azemi parashtrori pyetje për drejtoreshën, duke thënë se a ka ndonjë zhvillim tjetër lidhur me mungesën e ndriçimit në shumë pjesë të Prishtinës, sepse është një ndër problemet kryesore në qytet.

Medina Braha, lidhur me pyetjen e parashtruar dha sqarime të nevojshme.

Fadil Gashi pyeti se pse në fshatin Mramor tash e 8 muaj, një pjesë e rrugës së këtij fshati nuk ka ndriçim fare.

Medina Braha theksoi se nëse aty ka pasur rrjet të ndriçimit edhe para 8 muajve, problemi është të mirëmbajtja.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe dërgohet në Kuvend.

Pika e tretë

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin 2019.

Osman Bllaca dha sqarime lidhur me raportin e auditimit, duke cekur se raporti ka ardhur pozitiv sa i përket Njesisë së auditimit të brendshëm, por është problem investimi i ulët në investime kapitale, ku vetëm 41% e realizimit të tyre paraqesin një rezultat të ulët.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin 2019, dhe dërgohet në Kuvend.

Pika e katërt

Informatë nga Drejtoria e Parqeve mbi menaxhimin e hapësirave të gjelbra dhe parqeve në komunën e Prishtinës.

Fatime Hajdari, drejtoreshë e DP-së, dha sqarime, duke cekur se kur është dërguar materiali, ka qenë vetëm raporti për gjashtë mujorin e parë, ndërsa nuk na ka ardhur ndonjë kërkesë për ta plotësuar raportin për gjashtëmujorin e dytë.

Kryesuesi tha se në Kuvend gjatë prezantimit do të përfshihet edhe kjo informatë.

Agim Gashi theksoi se dallimet në mes të informatës dhe raportit janë esenciale. Informata është një pasqyrë përshkruese, provizore për përmbajtjen që e prezanton, ndërsa raporti është prezentim në detale të të gjitha të dhënave të nevojshme, që nga planifikimi deri te realizimi.

Po ashtu, ceku se në raport janë disa gjëra që ngatërrohen me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, se Drejtoria e Parqeve ka qenë pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Kur jemi te shërbimet publike, po e ngriti një çështje aty në informatë, te mbeturinat, thuhet se janë 145 deponi të egra, ku 125 prej tyre janë të larguar. Kërkoj të dijë se ku i keni dërguar mbeturinën e ngurtë si Komunë kur e keni pastruar, dhe a keni vend të caktuar për këtë.

Unë e dijë se nuk ka vend për dërgimin e tyre, andaj është në kompetencë të Komunës ta caktojë një pikë që nuk e pengon askënd, në pronë publike, për grumbullimin e tyre. Nëse janë dërguar në fshatin Barilevë, në ato fushat, a e keni kontaminuar atë pjesë atje. Kjo çështje duhet të rregullohet njëherë e përgjithmonë.

Medina Braha dha sqarime, duke cekur se kur është fjala për caktimin e një lokacioni për deponinë, kemi pasur takim me Drejtorinë e Pronës dhe Drejtorinë e Planifikimit, ku është identifikuar një lokacion dhe ka mbetur Drejtoria e Planifikimit me shikuar për ta gjetur një lokacion të përshtatshëm për këtë qëllim. Janë duke punuar në këtë drejtim, por normalisht që Prishtina ka problem këtë çështje, duke e pasur parasysh numrin e vogël të pronave.

Agim Gashi shprehu mendimin se nuk duhet lokacion shumë i madh, se mbeturinat e ngurta riciklohen, ku më se 90% e tyre rifuten në përdorim, andaj duhet investuar në riciklimin e tyre, sepse krejt ai material përdoret për tamponizim dhe klasifikohet sipas llojit.

Jeta Rafuna pyeti se si është gjendja e Parkut të aventurave, i cili planifikohet të ndërtohet.

Fatime Hajdari, drejtoreshë, dha shpjegime, duke thënë se sa i përket projektit për Parkun e aventurave, nuk është në kompetencë të Drejtorisë së Parqeve, por është në kompetencë të Drejtorisë së Kulturës. Kompetencë e Drejtorisë së Parqeve është mbjellja, kujdesi dhe regjenerimi i hapësirave të gjelbra.

Egzon Azemi bëri vërejtje rreth projektit për ndërtimin e Parkut të aventurave në zonën e Gërmisë, duke thënë se si ide është e mirë dhe e qëlluar, por lokacioni i propozuar është i papërshtatshëm, për shkak se Gërmia është e ngarkuar dhe nëse një projekt i tillë do të bëhet në ndonjë zonë tjetër rurale të Prishtinës, kishte mundur me i shtuar edhe atraksion, pra me i dhënë njëfarë forme pasuri më shumë qytetit.

Genc Bashota, drejtor, dha sqarime lidhur me këtë çështje, duke cekur se ky është peizazh i mbrojtur, nuk është park nacional. Peizazh i mbrojtur janë disa kategori që lejohen në Gërmia, disa aktivitete, jo të gjitha janë të mbyllura. Ne vetëm lejen mjedisore e kemi dhënë në bazë të kritereve.

Agim Gashi u shpreh i pajtimit me parafolësin, se lugina e Gërmisë është e mbingarkuar me gjithë çka, ku këtë ngarkesë mundemi me shpërndarë edhe në zona të tjera, siç është lugina e Zllatarit. Pra ka pjesë alternative ku edhe lidhen me Gërminë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Informata nga Drejtoria e Parqeve mbi menaxhimin e hapësirave të gjelbra dhe parqeve në komunën e Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend.

Pika e pestë

Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit", në Prishtinë.

Genc Bashota dha sqarime, duke cekur se kjo temë ka kaluar një herë në Kuvend dhe se Universiteti i Prishtinës e ka dhënë propozimin si do të dukej kjo hapësirë e sistemuar për disa fakultete, kryesisht Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti Teknik. Lidhur me këtë propozim plan banorët kanë bërë vërejtje për një bllok, T-6, që është pjesë e gjelbër afër rrugës, dhe komisioni i ka aprovuar vërejtjet e banorëve. Është kthyer rekomandimi për revidimin e planit, ku do ta bëjnë hapësirën T-6 si një hapësirë gjelbëruese për gjithë banorët. **Agim Gashi** kërkoi të dijë se në cilën pjesë, a është në pjesën jugore të objekteve ekzistuese, apo është ku ka qenë i planifikuar Teatri i Operës dhe Baletit.

Genc Bashota tha se kjo është pjesa ku ka qenë i planifikuar Teatri i Operës dhe Baletit.

Agim Gashi informoi se ka një fletë poseduese të Ministrisë së Kulturës, ajo parcelë është e Ministrisë së Kulturës, sepse kur është marrë vendimi për caktimin e lokacionit asokohe, Komuna e Prishtinës këtë parcelë ia ka bartur në pronësi Qeverisë së Kosovës.

Është mirë të mos ndodhë një gjë e tillë, që në pronën e Qeverisë të jepen leje për ndërtim të objekteve.

Genc Bashota tha se sipas informacioneve që kemi, ajo pronë iu ka dhënë në shfrytëzim, faktikisht ka qenë caktimi i lokacionit e jo dhënie e pronës. Këtë çështje do ta diskutojmë edhe në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit", në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme, për vitin 2021.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme, për vitin 2021, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për formimin e komisionit për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021.

Kryesuesi konstatoi së u miratua Propozimvendimi për formimin e komisionit për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Diskutim lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Termokos", SHA, Prishtinë.

Kryesuesi konstatoi së u miratua diskutimi lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Termokos", SHA, Prishtinë, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e nëntë

Propozimrregullorja e punës së Këshillit drejtues të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona".

Kryesuesi konstatoi së u miratua Propozimrregullorja e punës së Këshillit drejtues të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dhjetë

Propozimrregullorja për caktimin e procedurave të dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim për më pak se një vit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimrregullorja për caktimin e procedurave të dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim për më pak se një vit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për subvencionimin e çerdheve me bazë në komunitet.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për subvencionimin e çerdheve me bazë në komunitet dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dymbëdhjetë

Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit nr. 01-464/01-263767/18, dt.01.11.2018, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për plotësim - ndryshimin e Vendimit nr. 01-464/01-263767/18, dt.01.11.2018, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Të ndryshme

Agim Gashi, propozoi që në seancën e radhës se Kuvendit (të premtën), të futet si pikë e rendit të ditës: "Zgjedhja e një aksionari në kompaninë "Pastrimi".

Osman Billaca theksoi se nuk e kemi vetëm këtë ndërmarrje, por i kemi edhe tri ndërmarrje me mungesë të aksionarëve, të cilët kanë dhënë dorëheqje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55 .

**Procesmbajtësja
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta**

